



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr. 429/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NNSH “World Premium” SH.P.K me seli në Malishevë, me përfaqësues të autorizuar Z.F., kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulim vendimi Nr. 231/20 të datës 08.05.2020 jashtë seancës, me datë 03.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit “NNSH “World Premium” SH.P.K me seli në Malishevë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulim vendimi Nr. 231/20 të datës 08.05.2020.
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Me datë 27.05.2020 në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësi NNSH “World Premium” SH.P.K me seli në Malishevë, e përfaqësuar sipas autorizimit të dt. 15.05.2020 nga Z.F., ka parashtruar padi kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulim vendimi Nr. 231/20 të datës 08.05.2020 Lënda është evidentuar me nr. A.881/2020.

Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA 429/22.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësi NNSH “World Premium” SH.P.K me anë të parashtresës të datës 13.03.2024 në këtë gjykatë, ka njoftuar gjykatën se paditësi e tërheq padinë për këtë çështje të konfliktit administrativ me arsyetim se nuk ka interes juridik për procedimin e kësaj çështje sepse ka kaluar kohë e gjatë nga parashtrimi i padisë dhe janë të angazhuar në projekte të tjera.

Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së paditësit për tërheqje të padisë konstatoj se paditësi e tërheq padinë me deklarin e tij të lirë dhe i vetëdijshëm për pasojat ligjore të tërheqjes së padisë, andaj konform nenit 261 par. 2 dhe par 3 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi

Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.429/22, datë 03.04.2024

Gjyqtarja  
Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE :** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.